

Hec Lanabregas Sh.a

Pasqyrat financiare

31 dhjetor 2015

Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimë	31 dhjetor 2015 (Lekë)	31 dhjetor 2014 (Lekë)
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare dhe ekvivalentet e saj	6	51,595,414	7,766,855
Llogari të arkëtueshme	7	64,543,691	5,320,224
Inventarët	8	3,606,367	727,170
Shpenzime të shtyra		-	70,000
		119,745,472	13,884,250
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	177,755,998	-
		177,755,998	-
Total i Aktiveve		297,501,470	13,884,250
Detyrimet			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	9	60,216,947	52,853
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig. shoqërore/shëndetësore	10	1,960,163	1,871,706
Të pagueshme për detyrime tatimore	11	14,887,511	1,114,505
Të tjera të pagueshme	12	265,998	116,178
Totali i detyrimeve		77,330,619	3,155,242
Detyrimet dhe Kapitali			
Kapitali	13	192,397,676	10,000,000
Rezerva të tjera	13	729,007	-
Fitimi/Humbja e vitit	13	27,044,168	729,007
Totali i Kapitalit		220,170,851	10,729,007
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		297,501,470	13,884,250

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Hec Lanabregas Sh.a më 20 prill 2016 dhe firmosur për llogari të tyre nga:



Florian Pullazi
Administrator


Besnik Xhuti
Kontabilist

Pasqyra e pozicionit finanziar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

HEC LANABREGAS SH.A

Pasqyrat financiare

31 dhjetor 2015

Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve dhe të tjera gjithëpërfshirëse

31 dhjetor
2015
(Lekë)

31 dhjetor
2014
(Lekë)

Shënimet

Të ardhurat	14	118,332,013	12,766,512
Shpenzimet operative			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	15	(49,771,757)	(81,504)
Shpenzime administrative	16	(5,988,319)	(984,392)
Shpenzime personeli	17	(28,633,718)	(10,847,039)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5	(2,088,974)	-
Fitimi/(humbja) operative		31,849,245	853,577
Te ardhura financiare / (shpenzime), neto	18	5,984	4,079
Fitimi para tatimit		31,855,229	857,656
Shpenzim tatim fitimi	19	4,811,061	128,648
(Humbja)/Fitimi neto për vitin		27,044,168	729,007
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		27,044,168	729,007
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



HEC LANABREGAS SH.A

Pasqyrat financiare

31 dhjetor 2015

Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

Pasqyra e Flukseve Monetare

Shënim	31 dhjetor 2015 (Lekë)	31 dhjetor 2014 (Lekë)
Flukset monetare nga aktiviteti operativ		
Fitimi para tatimit	31,855,229	857,656
Rregullime për:		
Zhvlerësimi dhe amortizime	5	2,088,974
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	33,944,203	857,656
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>		
Të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	(59,223,467)	(5,388,797)
Shpenzime te shtyra	70,000	
Inventarë	378,507	(727,170)
Detyrime ndaj punonjësve	88,457	1,871,706
Të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	69,602,479	1,282,108
Tatim fitim i paguar	(326,621)	(128,648)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative	44,533,559	(2,233,145)
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(705,000)	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese	(705,000)	-
Rritja/(Rënja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre	43,828,559	(2,233,145)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	7,766,855	10,000,000
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	51,595,414	7,766,855

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



HEC LANABREGAS SH.A
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksioner	Rezerva të tjera	Fitime / (humbje) e pasperndare	Totali
Gjëndja më 1 janar 2014	-	-	-	-
Fitim/Humbja e vitit			729,007	729,007
Emetimi i kapitalit	10,000,000	-	-	10,000,000
Gjëndja më 31 dhjetor 2014	10,000,000	-	729,007	10,729,007
Gjëndja më 1 janar 2015	10,000,000	-	729,007	10,729,007
Fitim/Humbja e vitit			27,044,168	27,044,168
Rezerva te tjera	-	729,007	(729,007)	-
Emetimi i kapitalit te nenshkruar	182,397,676	-	-	182,397,676
Gjëndja më 31 dhjetor 2015	192,397,676	729,007	27,044,168	220,170,851



Hec Lanabregas Sh.a
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

Shënimet për Pasqyrat Financiare

1. Të përgjithshme

Shoqëria "Hec Lanabregas Sh.a" ("Shoqëria") është regjistruar në QKR më datë 18.07.2014 dhe është pajisur me NIPT L41918001E. Adresa e selisë qendrore së shoqërisë është "Tirane Dajt Lanabregas, Komuna Dajt".

Aksioner i vetëm i Shoqërisë është Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a dhe objekt të veprimitarisë së saj ka prodhimin dhe tregimin e Energjisë Elektrike. Për vitin 2014 dhe në vijim deri në datë 08 Qershor 2015 midis Hec Lanabregas Sh.a dhe UKT sh.a është lidhur kontratë porosie për prodhimin e energjisë elektrike duke përdorur me Kontratë Huapërdorje, asetet e Hidrocentralit në pronesi të UKT sh.a. Sipas kësaj kontrate UKT sh.a. paguante shpenzimet e kryera si dhe një fitim prej një përqind mbi këto shpenzime. Në datë 08 Qershor 2015 Enti Rregullator i Energjisë me Vendimet Nr 78 dhe 79 ka pajisur Shoqerinë Hec Lanabregas sh.a me licencat e prodhimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike. Për periudhën nga data 09 Qershor 2015 e në vijim është lidhur kontratë shit-bljerje energjie midis KESH sh.a dhe Hec Lanabregas sh.a me çmimin fiks prej 7.636 lekë/kwh.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Florian Pullazi.

2. Bazat e përgatitjes dhe deklarata e përputhshmërisë

2.1 Deklarata e përputhshmerise

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit Pasqyrat Financiare në përputhje me legjislacionin Kontabël në Shqiperi.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike. Bazat e matjes për cdo aktiv, detyrim, të ardhur apo shpenzim shpjegohen me detaje në vazhdim të këtij shënimini shpjegues.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon të përdoren vlerësimet të rëndësishme kontabël. Gjithashtu është e nevojshme që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë. Fushat në të cilat kanë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose ku supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim domethënës në pasqyrat financiare janë të paraqitura në shënimin 4.4 "Gjykime dhe çmuarje të rëndësishme kontabël".

3. Përbledhje e politikave kontabël

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë. Këto politika janë përdorur në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e prezantuara, përvce kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në valutë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, që përfaqëson monedhën funksionale të shoqërisë. Përvce në rastet kur shprehet ndryshe, informacioni finanziar eshtë i paraqitur në Lekë.

(b) Transaksionet dhe tepricat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në Lekë duke përdorur kursin e ditës në datën e transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk përkthehen në fund të periudhës por maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur eshtë kryer transaksiuni), përvce rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur eshtë përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për të përkthyer zërat në Pasqyrën e pozicionit finansiar të shprehura në monedhë të huaj, janë si më poshtë:

3.2 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë fluksset hyrëse bruto të përfshimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat vijnë si rezultat i aktivitetit të zakonshëm të shoqërisë dhe rezultojnë në tritje të kapitalit përveç rasteve të tritjes së kapitalit nga kontributet e aksionareve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë e të arkëtueshmeve ose të hyrave nga shitja e të mirave dhe shërbimeve që vijnë nga aktiviteti i zakonshëm i shoqërisë. E ardhura paraqitet neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar ("TVSH"), kthimet, uljet tregtare dhe duke hequr shitjet brenda shoqërise nëse ka.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

Të ardhurat njihen nëse ka mundësi që të realizohen fluksë të ardhshme hyrëse dhe këto fluksë mund të maten në mënyrë të besueshme.

3.3 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet përfshijnë njihen dhe ngarkohen kundrejt provisionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

3.4 Shpenzimet e qirave

Shpenzimet e qirave, në të cilat një pjesë e madhe e riskut dhe përfitimeve të pronësisë mbarten nga qiradhënsi, klasifikohen si qira operacionale. Pagesat e kryera përfshijnë qiranë operacionale (neto nga ndonjë përfitim të marrë nga qiradhënsi) ngarkohen në fitim ose humbje me metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, nuk ka asnjë makineri, pajisje apo automjet përfshinë të cilët shoqëria të marrë përsipër të gjitha treguara dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e tyre, prandaj të gjitha qiratë klasifikohen si qira operacionale.

3.5 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni Shqiptar në fuqi të depozitojë kontributet fiksë përfshinë të punonjësve në një fond social që manaxhohet nga Qeveria. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën në të cilën i takojnë.

3.6 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale mbahen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit.

Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit vëtëm kur është e mundshme që në të ardhmen ato të sjellin përfitime ekonomike përfshinë, dhe kur kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet njihen në fitim ose humbje në periudhën financiare në të cilën ato ndodhin. Zhvlerësimi illogaritet duke përdorur metodën lineare. Normat e përdorura të amortizimit janë si më poshtë:

Aktive afatgjata materiale	%
Ndertesa	1%-5%
Mjete transporti, makineri dhe pajisje zyre	20%-25%
Pajisje kompjuterike	20%-25%

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale rishikohet, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivi shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale përcaktohen si diferençë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivit dhe njihet në fitim ose humbje të periudhës financiare.

3.7 Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë koston e licencave përfshinë kompjuterike të cilat kapitalizohen nëse janë kryer përfshinë treguara dhe instaluar programin kompjuterik. Këto koston amortizohen mbi jetën e tyre të dobishme. Amortizimi ngarkohet në masën 5% me metodën e vlerës së mbetur. Shoqëria nuk ka investuar ne aktive afatgjata jomateriale gjate vitit 2015 dhe 2014.



3.8 Instrumentet financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur shoqëria bëhet palë kontraktuale e instrumentit finansiar dhe maten fillimi me vlerën e drejtë të rregulluar me kostot e transaktionit, përvèç atyre të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes të cilat njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe kostot e transaktionit shpenzohen në fitim ose humbje.

3.9 Aktivet financiare

Shoqëria klasifikon aktivet e saj financiare në këto kategoritë: aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, aktive financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë blerë aktivet. Drejtimi vendos klasifikimin e aktiveve financiare që në momentin e njohjes fillostarte dhe e rivlerëson atë në çdo datë reportuese.

a) Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategoritë: aktivet financiare të mbajtura për tregim dhe ato të klasifikuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që në fillim. Një aktiv finanziar është i klasifikuar në këtë kategorinë nëse është blerë me qëllim për tu shitur në një periudhë afatshkurtër, nëse ai përbën një pjesë të portofolit të aktiveve financiare për të cilat ka evidence për realizimin e fitimeve afatshkurtra. Aktivet në këtë kategorinë janë klasifikuar si aktive afatshkura, shoqëria nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategorinë.

(b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv letrash me vlerë, përvèç atyre që shoqëria kërkon t'i shesë në periudhë afatshkurtër ose janë përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provisionin për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim përfundon me vlerën e drejtë të arkëtueshme, kur ka evidencë objektive që shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përpunim me kushtet e tyre në momentin fillostar. Mjetet monetare, të arkëtueshme nga kontrata e ndërtimit, të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme bëjnë pjesë në këtë kategorinë të aktiveve financiare.

(c) Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me afat maturimi fiks, përvèç atyre që plotësojnë kushtet e përkufizimit të huave dhe të arkëtueshmeve, që manaxhimi i kompanisë ka qëllimin e aftësinë t'i mbajë deri në maturim. Këto aktive njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe më pas maten me vlerën e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provisionin për zhvlerësim nëse ka. Një provizion për zhvlerësim përfundon me vlerën e drejtë të mbajtura deri në maturim, kur ka evidencë objektive që shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përpunim me kushtet e tyre origjinale. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategorinë në datën e raportimit.

(d) Aktive financiare të disponueshme për shitje

Aktivet financiare të disponueshme për shitje janë aktive financiare jo derivative të klasifikuara në këtë kategorinë ose që nuk janë të klasifikuara në ndonjë kategorinë tjeter. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategorinë në datën e raportimit.

Njohja fillostarte dhe gregjistrimi

Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen në ditën e tregimit, dita në të cilën shoqëria kryen blerjen apo shitjen e aktivit. Aktivet financiare njihen fillimi me vlerën e drejtë plus, në rast se aktivit nuk është mbajtur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaktionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Aktivet financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe kostot e transaktionit njihen në fitim ose humbje.



Aktivet financiare çregistrohen, kur të drejtat për të përsituar flukse të mjeteve monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përsitimet e pronësisë mbi aktivin.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivet financiare të disponueshme për shitje dhe aktivet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes maten edhe më pas me vlerën e drejtë. Huatë dhe të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë të përfshira në fitim ose humbje në zërin (humbje)/fitime të tjera në periudhën në të cilën ato ndodhin. Fitimet dhe humbjet e parealizuara që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve jo-monetare të klasifikuara si të disponueshme për shitje njihen në kapital. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si aktive financiare të disponueshme për shitje janë shitur ose zhvlerësuar, tregullimet e akumuluarat e vlerës së drejtë të njohura në kapital përfshihen në fitim ose humbje si "fitim ose humbje nga aktivet financiare".

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë të përfshira neto në fitim ose humbje në zërin (humbje)/fitime të tjera në periudhën në të cilën ato ndodhin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentave monetare dhe jo-monetare në kategorinë 'të disponueshme për shitje' njihen në kapital.

Interesi nga aktivet financiare të disponueshme për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe është njohur në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividendët nga aktivet financiare të disponueshme për shitje janë njohur në fitim ose humbje si pjesë e të ardhurave të tjera në momentin kur është fituar e drejta e kompanisë për të marrë pagesat në lidhje me to.

Vlera e drejtë e aktiveve të kuotuara është bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Në qoftë se tregu për një aktiv finanziar nuk është aktiv (dhe për letrat me vlerë të pa listuar), shoqëria e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Këto teknika përfshijnë marrjen në konsideratë të transaksioneve më të fundit, referencë me instrumenta financiare të tjere në substancë të ngashëm, analizën e skontimit të flukseve monetare etj.

3.10 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme ndaj aksionarëve. Detyrimet financiare njihen fillimi me vlerën e tyre të drejtë të përshtatura me kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Detyrimet financiare më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.11 Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shumat e tyre neto raportohen në pasqyrën e pozicionit finanziar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore e zbatueshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka qëllim për t'i vendosur mbi bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyeje detyrimin njëkohësisht.

3.12 Zhvlerësimi

3.12.1 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivin. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën e efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyre të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi timerret nese rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.13 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare te Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nese ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nese vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.14 Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatushëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e bilancit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatushme ose të zbritshëm në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatushme ose të zbritshëm.

3.15 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arke, depozita afatshkurtra në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturitet më pak se 3 muaj.

3.16 Provizonet

Një provizion njihet kur shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përsitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për vlerën e detyrimit. Provizonet nuk njihen për humbje të ardhshme operative. Provizonet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të duhen për të shlyer detyrimin, duke përdorur një normë skontimi e cila përfaqëson vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe treziqet specifike të detyrimit. Rritja e provizonit me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesë.

3.17 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nese mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përsitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nese është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3.18 Transakzionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe manaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.19 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financier (veprimet tregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime tregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Manaxhimi i rrezikut financier

4.1 Faktorët e rrezikut financier

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëlojshmërië tregiqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërtë mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Departamenti i financës së shoqërisë mëmë në Greqi merret me manaxhimin e rrezikut në bazë të politikave dhe procedurave të aprovuara nga bordi, të cilat mbulojnë manaxhimin e rrezikut në përgjithësi, si dhe fusha specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, përdorimi i instrumentave financiare të duhur dhe investimi i likuiditetit të tepert.

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si pasojë e ndryshimit të çmimeve, kursit të këmbimit dhe normës së interesit në treg. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment te caktuar varet nga kushtet në të cilat ndodhet tregu, pritshmëritë për çmimet në të ardhmen ose lëvizjet në normat e interesit të tregut, përbëja e aktiveve materiale të shoqërisë dhe kontratat në të cilat shoqëria është përfshirë.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen kur ka njohje të transaksioneve tregtare si aktive ose detyrime në një monedhë e cila është e ndryshme nga monedha funksionale e shoqërisë. Shoqëria nuk e diversifikon ekspozimin ndaj këtij lloj rreziku sepse nuk pret humbje të konsiderueshme si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit me monedhat e huaja krahasuar me kursin në datën e raportimit.

Shoqëria nuk ka kryer transaksione në monedhë të huaj gjate vitit 2015 dhe 2014.

(ii) Rreziku i çmimit

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të çmimit të kapitalit sepse nuk zotëron aktive financiare në përbërjen e instrumenteve të kapitalit në datën e raportimit. Nuk është politikë e shoqërisë të blejë këto lloj instrumentesh dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit që lidhet me lëvizjet e indekseve të tregut të kapitalit.

Shoqëria, ka klient UKT, që është edhe mëma deri në datën 08 Qershor 2015 sipas kontratës së porosisë lidhur ndërmjet tyre, sipas të cilës UTK paguante shpenzimet e kryera si dhe një fitim prej një përqind mbi këto shpenzime. Nga data 09 qershor 2015, ka klient KESH-in sipas kontratës së shit-blerjes së energjisë lidhur midis KESH dhe HEC Lanabregas sh.a, kundrejt te cilit shet me një cmim fiks te aprovar edhe nga enti tregulator.



(iii) Rreziku i normës së interesit

Të gjithë aktivet e shoqërisë të cilat mbartin interesa lidhen me llogaritë në banka. Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset e parave nga aktiviteti operacional nuk janë të ekspozuar në masë të konsiderueshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

(b) Rreziku i kreditit

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kreditit, i cili ka të bëjë me rrezikun qe njëra palë e një instrumenti financiar të shkaktoje një humbje financiare për palen tjetër duke dështuar të shlyejë detyrimet.

Rreziku i kreditit vjen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, depozitat në banka dhe institucionet financiare si dhe ekspozimi nga kreditimi i klientëve, duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme dhe transaksionet e kryera. Rreziku i kreditit që vjen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj dhe depozitat bankare konsiderohet i papërfillshëm, sepse pala tjetër janë banka me reputacion dhe me cilësi të lartë sipas klasifikimeve nga agjencitë e huaja.

Rreziku maksimal i ekspozimit të shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera e mbetur e secilit aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari të arkëtueshme	64,543,691	5,320,224
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	51,595,414	7,766,855
Totali	116,139,104	13,087,079

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditishme për burime monetare, kryesish për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

31 dhjetor 2015	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivet financiare				
Llogari të arkëtueshme	64,543,691	-	-	64,543,691
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	51,595,414	-	-	51,595,414
Totali	116,139,104	-	-	116,139,104
Detyrimet financiare				
Llogaritë të pagueshme	60,216,947	-	-	60,216,947
Totali	60,216,947	-	-	60,216,947
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2015	55,922,157	-	-	55,922,157

Hec Lanabregas Sh.a
 Pasqyrat financiare
 31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2014				
Aktivet financiare				
Të arkëtueshme nga kontrata e ndërtimit	5,320,224	-	-	5,320,224
Mjetet monetare dhe ekivalenjtë e saj	7,766,855	-	-	7,766,855
	13,087,079	-	-	13,087,079
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	52,853	-	-	52,853
	52,853	-	-	52,853
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2014	13,034,226	-	-	13,034,226

Shoqëria nuk ka hua afatgjatë në datën e raportimit.

4.2 Manaxhimi i rrezikut të kapitalit

Manaxhimi i trezikut të kapitalit nuk është i nevojshëm për aktivitetin e shoqërisë. Shoqëria është 100 % e zotëruar nga UKT sh.a. Shoqëria mëmë, nëpërmjet prezencës në strukturën mbikqyrëse dhe mbikqyrjes në terren sigurohet që nevojat për kapital aksionar të jenë të përbushura. Kapitali minimal që shoqëria duhet të mbajë është 2,000,000 Lekë.

Raporti borxh/kapital

Struktura e kapitalit të shoqërisë analizohet si me poshtë:

Kapitali	192,397,676	10,000,000
Reserva të tjera	729,007	-
Fitim/Humbja e vitit	27,044,168	729,007
Totali i Kapitalit	220,170,851	10,729,007

4.3 Vlerësimi me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushte të tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e aktivitit dhe bazën e detyrimit.

(a) Aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera duhet të përafrohet me vlerën kontabël përderisa janë instrumente afatshkurtër.

(b) Detyrimet financiare të mbajtura me koston e amortizuar

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme dhe të pagueshme të tjera duhet të përafrohet me vlerën e drejtë. Shoqëria nuk mban detyrime të tjera financiare.

4.4 Gjykime dhe çmuarje të rëndësishme kontabël

Në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë, të cilat përshkruhen në shënimin shpjegues 3, drejtimi i duhet të bëjë vlerësimë, gjykime dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyimeve që nuk kanë një vlerësim të quartë nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to bazohen në experienca të mëpërparshme dhe faktorë të tjera që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të janë të ndryshme nga këto vlerësimë dhe supozime.

Shoqëria bën vlerësimë dhe supozime lidhur me të ardhmen. Vlerësimet kontabël trallë do të rezultojnë të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar ndryshime materiale në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyimeve brenda vitit të ardhshëm financiar shtjellohen më poshtë.

Paqartësia në gjykime

(a) Vlera e drejtë e aktiveve financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiare të cilat nuk tregëtohen në një treg aktiv (të gjitha aktivet e Shoqërisë) përcaktohet duke përdorur metoda vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin në zgjedhjen e metodave të ndryshme dhe bën supozimet që bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në cdo datë raportimi.

(b) Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon jetën e dobishme të aktiveve të amortizuara në çdo datë të raportimit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e përcaktuar e aktiveve përfaqëson përdorimin e pritshëm të aktivit. Vlera kontabël e këtyre aktiveve analizohet në shënimin shpjegues 6. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të daljes jashtë përdorimit si pasojë e teknologjisë.

(c) Njohja e të ardhurave

Shoqëria përdor metodën e njohjes së të ardhurave sipas fazës së përfunduar të punimeve dhe çmimet fiksë të përcaktuara në kontratë. Përdorimi i kësaj metode kërkon që shoqëria të vlerësojë shërbimin e kryer në një datë, në proporcion me shërbimin total të parashikuar. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga vlerësimet dhe parashikimet e bëra.

(d) Inventari

Inventari matet me më të voglën midis kostos dhe vlerës së tregut. Në vlerësimin e vlerës së tregut, drejtimi merr në konsideratë evidencat më të besueshme që janë në kohën kur bëhet vlerësimi.



Hec Lanabregas Sh.a
 Pasqyrat financiare
 31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

5 Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndertesa dhe Instalime	Makineri e pajisje	Mjete transporti	Asete ne magazine	Mobilje dhe pajisje zyre	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2014							
Shtesa							
Gjendja me 31 dhjetor 2014	-	-	-	-	-	-	-
Transferim i aseteve	26,050,738	51,817,285	96,645,982	423,675	4,187,709	14,583	179,139,972
Shtesa	-	-	-	-	289,000	416,000	705,000
Gjendja me 31 dhjetor 2015	26,050,738	51,817,285	96,645,982	423,675	4,476,709	430,583	179,844,972
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2014							
Amortizimi për vitin	-	(323,820)	(1,567,012)	(141,225)	-	(56,917)	(2,088,974)
Gjendja me 31 dhjetor 2015	-	(323,820)	(1,567,012)	(141,225)	-	(56,917)	(2,088,974)
Vlera neto							
Gjendja me 31 dhjetor 2014							
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2015	26,050,738	51,493,465	95,078,970	282,450	4,476,709	373,666	177,755,998

Hec Lanabregas Sh.a
 Pasqyrat financiare
 31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

6 Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paraja në banka (Banka Kombëtare Tregtare)	51,595,414	7,766,855
Totali	51,595,414	7,766,855

Mjetet monetare janë vlerësuar ne vlerën nominale. Nuk ka gjendje mjetesh monetare në arkë për 2014 dhe 2015.

7 Llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të arkëtueshme nga Kliente per mallra, produkte e sherbime	64,543,691	5,320,224
Totali	64,543,691	5,320,224

Gjëndja e klienteve në fund të periudhës përbëhet nga fatura e shërbimit e periudhës 01.06.2015-08.06.2015 faturuar ndaj UKT si dhe detyrimi i KESH per një pjese te faturës së periudhës 09.06.2015-30.11.2105.

8 Inventari

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Inventar	3,606,367	727,170
Totali	3,606,367	727,170

Hyrjet në inventar kanë të bëjnë me hyrjen e materialeve me vlerë 3,257,704 lekë mbas transferimit të aktivitetit të prodhimit dhe tregimit të energjisë si dhe blerje gjate vitit me vlerë 15,000 lekë. Daljet prej 393,507 lekë janë përfshirë në koston e mallrave të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

9 Llogari të pagueshme

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorë per mallra, produkte e sherbime	60,216,947	52,853
Totali	60,216,947	52,853

Gjëndja e detyimeve ndaj furnitorëve në fund të periudhës i përket furnitorit Eurogjici Security Sh.p.k, për faturën e muajit Dhjetor 2015, furnitorit telefonik Plus Communication për muajin Nëntor 2015 si dhe furnitorit UKT për faturat e ujit për periudhën 09.06.2015-30.11.2015.

10 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paga e shperblime	1,463,157	1,389,516
Kontribute shoqërore të pagueshme	494,908	482,190
Të pagueshme ndaj punojësve per shpenzime telefonike	2,099	-
Totali	1,960,163	1,871,706

15 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Blerje e lendës së parë	49,337,466	-
Kosto e mallrave	393,507	76,978
Blerje energji, avull, uje	40,784	4,526
Totali	49,771,757	81,504

Në ketë grup përfshihen kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe sherbimeve në veprimaritë parësore.

16 Shpenzime administrative

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Qera	840,000	280,000
Mirmbajtje/Riparime	203,900	-
Sigurim objekti	2,719,822	-
Personel nga jashtë shoqerise	2,130,000	692,142
Shpenzime postare dhe telefoni	30,000	9,000
Sherbime bankare	5,300	3,250
Gjoba dhe interesa	59,297	-
Totali	5,988,319	984,392

Në këto shpenzime një zë i vecantë janë gjobat dhe interesat e llogaritura dhe të paguara ndaj Organave Tatimore për moslikuidimin në kohë të detyrimeve ndaj tyre. Shoqëria përt arsyen e vonesës së lidhjes së kontratës me Kesh.sh.a ka kaluar në gjendjen e paftesishë paguese nga muaji Shtator deri në datë 30.12.2015, datë në të cilën është berë arkëtimi pjesor i faturave nga KESH sh.a. Për efekte tatimore këto shpenzime klasifikohen si shpenzime të pazbritshme.

17 Shpenzime personeli

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Pagat e personelit	24,546,772	9,570,229
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	4,086,946	1,276,810
Totali	28,633,718	10,847,039

18 Të ardhura (shpenzime) financiare

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat	5,984	4,079
Totali	5,984	4,079

Hec Lanabregas Sh.a
 Pasqyrat financiare
 31 dhjetor 2015
Shumat janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

19 Shpenzime tatim fitimi

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Tatimi mbi fitimin	4,811,061	128,648
Totali	4,811,061	128,648

Tatimi mbi fitimin i shoqërisë është llogaritur duke bërë rregullimet në fitimin kontabël për shpenzimet e pazbritshme dhe të ardhurat e panjohura si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	31,855,229	857,656
Rregullime për:		
Shpenzime të pazbritshme	218,514	-
Baza e tatushme	32,073,743	128,648
Norma e takses	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	4,811,061	857,656

20 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, nga dispozitat e fundit për këto çështje, shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin finansiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përvèç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit finansiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Hec Lanabregas Sh.a eshte dorezanes per kredine e marre me date 31 korrik 2015 midis shoqërise mëmë Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) Sh.a dhe Bankes Kombetare Tregetare per vleren 1,000,000,000 lekë.

21 Transaksionet me palët e lidhura

Shoqëria gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm ka transaksione me palët e lidhura. Tabela më poshtë është një përbledhje e gjendjes së transaksioneve me palët e lidhura:

	Të arkëtueshme	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015				
UKT Sh.a	957,831	8,565,938	17,457,720	49,337,466
Anëtarë të këshillit mbikëqyrës	-	265,998	-	-
	957,831	8,831,936	17,457,720	49,337,466

	Të arkëtueshme	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014				
UKT Sh.a	5,320,224	-	12,766,512	-
Anetare të këshillit mbikëqyrës	-	116,178	-	-
	5,320,224	116,178	12,766,512	-

Hec Lanabregas Sh.a
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2015
Shumiaj janë në lëke nese nuk shprehet ndryshe

22 Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare të cilat mund të kërkojnë korrektimin e pasqyrave financiare.

